



Periodiku AMF

Zhvillohet trajnimi dy javor mbi bazat e menaxhimit të riskut dhe hyrje në sigurime

Autoriteti i Mbiqyrjes Financiare në bashkëpunim me F SVC, zhvilloi gjatë periudhës 31 maj - 11 qershor 2010, në ambientet e “Zayed Center”, trajnimin dy javor mbi bazat e menaxhimit të riskut dhe hyrje në sigurime.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve për gjashtëmujorin e parë 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - qershor 2010 arritën shifrën 3,974,071 mijë lekë, përkundrejt 4,061,540 mijë lekë të realizuara në janar - qershor 2009 ose 2.15% më pak.

Vijon në faqen 2

Zhfillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për gjashtëmujorin e parë 2010

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar - qershor 2010 u dominua në masën 93.59% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 6.41% nga instrumenta afatgjatë (obligacione)

Vijon në faqen 4

Zhfillimet e tregut të pensioneve vullnetare private për gjashtëmujorin e parë 2010

Tregu i pensioneve vullnetare zë një peshë të vogël në tregun financiar jo-bankar në Shqipëri. Pavarësisht dinamikës së lartë të rritjes së kontributeve dhe numrit të kontribuesve, përkatësisht në masën 40.86% dhe 8.63% për gjashtëmujorin e parë 2010, ky treg është ende larg potencialit të tij real për zhvillim të mëtejshëm.

Vijon në faqen 6

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet seminari mbi mbikëqyrjen me bazë risku

Organizata Ndërkombëtare e Mbiqyrjes të Pensioneve IOPS, në bashkëpunim me Autoritetin e Mbiqyrjes Financiare të Polonisë zhvilluan në Varshavë, Poloni, gjatë periudhës 26-27 korrik 2010 seminarin me temë: Mbiqyrja me Bazë Risku.

Vijon në faqen 6

Zhvillohet seminari i 6-të i mbikëqyrjes ndërkombëtare të sigurimeve mbi çështjet kryesore të mbikëqyrjes

Gjatë periudhës 18-23 korrik në Beatenberg, Zvicër, FSI zhvilloi seminarin e 6-të të mbikëqyrjes ndërkombëtare të sigurimeve mbi çështjet kryesore të Mbiqyrjes.

Vijon në faqen 7

Edukimi i konsumatorit

Përparësitë e një standardi global për aftësinë paguese

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Geneva Papers, Vol. 35, nr. 1, 2010)

Vijon nga numri i kaluar...

Një qasje mbikëqyrjeje globale

Përparësitë e një qasjeje mbikëqyrjeje globale

Pa dyshim, një qasje globale për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit do të kishte disa përparësi për mbikëqyrësit, për shoqëritë e sigurimit e risigurimit dhe për policmbajtësit e tyre. Shumë vende i kanë ndryshuar ose janë duke i ndryshuar sistemet e tyre rregullatore për të pasur një qasje më të bazuar në risk.

Vijon në faqen 8

Në këtë numër:

Zhvillohet trajnimi dy javor mbi bazat e menaxhimit të riskut dhe hyrje në sigurime

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

2

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

6

Edukimi i konsumatorit

8

Zhvillohet trajnimi dy javor mbi bazat e menaxhimit të riskut dhe hyrje në sigurime

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me FSVC, zhvilloi gjatë periudhës 31 maj - 11 qershor 2010, në ambientet e “Zayed Center”, trajnimin dy javor mbi bazat e menaxhimit të riskut dhe hyrje në sigurime.

Ky kurs trajnimi është pjesë përbërëse e një programi të gjerë trajnimesh që do të vijojë gjatë këtij viti, në mbështetje të rritjes së njohurive të stafit të Autoritetit dhe pjesëmarrësve nga industria.

Gjatë javës së parë të këtij kursi, pjesëmarrësit u prezantuan me njohuritë bazë të menaxhimit të riskut, duke filluar me përkufizimin e riskut dhe menaxhimit të tij, llojet e risqeve dhe përcaktimet e tyre, si dhe qëllimet e përfitimit e menaxhimit të riskut. Temat që u përcollën më me interes ishin ato lidhur me hapat e krijimit të procesit të menaxhimit të riskut, teknikat e menaxhimit të riskut, si dhe zbatimi i programit të menaxhimit të riskut dhe roli e menaxherëve të riskut në një organizatë.

Gjatë javës së dytë, prezantimet u përqendruan në tema që trajtonin njohuri të përgjithshme rreth veprimtarisë së sigurimeve. Këto tema përfshinë njohuri lidhur me llojet dhe përcaktimet e risqeve të siguroeshme, natyrën dhe përmbajtjen e kontratave të sigurimit, si dhe llojet e sigurimit dhe risigurimit.

Z. William Cundiff, Lektor i këtij trajnimi, me një eksperiencë 40 vjeçare në fushën e sigurimeve, mundësoi që prezantimet teorike të pasuroheshin me shembuj konkretë nga praktika e tij në sigurime.

Në këtë trajnim morën pjesë anëtarë të stafit të AMF-së, shoqërive të sigurimit dhe FSVC-së. Kursi u zhvillua në formë prezantimesh të shoqëruara me diskutime dhe punë në grup.

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit u pajisën edhe me certifikata në fushën e sigurimeve.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve për gjashtëmuajorin e parë 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - qershor 2010 arritën shifrën 3,974,071 mijë lekë, përkundrejt 4,061,540 mijë lekë të realizuara në janar - qershor 2009 ose 2.15% më pak. Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 49.79% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 50.21% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme, primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 7.78% të sigurimeve të Jetës dhe një ulje 3.34% të sigurimeve të Jo-Jetës. 90.25% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 9.21% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës dhe 0.54 % nga risigurimi.


Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2010 u nënshkruan rreth 306,501 kontrata sigurimi, ose rreth 15.44% më pak se në janar - qershor të vitit 2009.

Sigurimet e detyrueshme


Gjatë janar - qershor 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 50.21 % të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për 6-mujorin 2010, arritën 1,457,173 mijë lekë, ose 0.13% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2009.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-qershor 2010




Struktura e tregut të sigurimeve, janar-qershor 2010



Volumi i primit të shkruar bruto, janar-qershor (2009-2010)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2009	2010
janar - qershor	2009	2010
A) Sigurim i Jetës	339,683	366,112
B) Sigurim i Jo-Jetës	3,710,454	3,586,670
a) Sigurimi i Detyrueshëm	2,154,272	1,995,530
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	1,556,182	1,591,139
c) Risigurimi	11,403	21,289
TOTAL	4,061,540	3,974,071

Volumi i primit të shkruar bruto, janar-qershor 2010 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Gjatë janar - qershor 2010, primit e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 422,530 mijë lekë, ose rreth 29.20% më pak se në janar - qershor 2009.

Primit e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar - qershor 2010 arritën në 115,827 mijë lekë, apo 13.33% më shumë se në janar - qershor 2009.

Sigurimet vullnetare

Në janar - qershor 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,978,540 mijë

lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), ose 3.74% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,612,428 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 33.54% të pasuara nga, sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 21.30% dhe nga sigurimi kasko me 18.73%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë, si dhe primet nga veprimtaria e risigurimit.



Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar - qershor 2010, arritën në 199,003 mijë lekë, 4.06% më pak se në janar - qershor 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim, me rreth 75.03% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar - qershor 2010 arritën në rreth 366,112 mijë lekë, ose rreth 7.78% më shumë se në janar - qershor 2009. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interbalkan, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 30.62% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 59.19% të primeve.



Dëmet


Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - qershor 2010 kapi vlerën 1,008,084 mijë lekë, ose 30.48% më shumë se në janar - qershor 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 861,068 mijë lekë, apo 83.63% të totalit.

Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për gjashtëmuorin e parë 2010

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar - qershor 2010 u dominua

në masën **93.59%** nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (*bono thesari*) dhe **6.41%** nga instrumenta afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, **98.80% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.**

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - qershor 2010, flasin për një dominim të transaksioneve “*Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar*” dhe “*Shlyerje e vlerës nominale në maturim*” përkatësisht me **20.47%** dhe **51.94%**



kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth **95.92%** të të gjitha transaksioneve në këtë treg, në raport me personat juridikë.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “**Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar**” gjatë periudhës janar - qershor 2010 ka pasur një rritje prej 321.31 milionë lekë ose në masën **6.25%**, krahasuar me vitin 2009, shoqëruar me një ulje në masën **3.74%** të numrit të transaksioneve.

Transaksioni i llojit C “**Blerje nga individët para afatit të maturimit**” gjatë periudhës janar - qershor ka pasur një rritje prej 897.55 milionë lekë ose **135.59%**, krahasuar me vitin 2009, ndjekur nga një rritje në masën **118.50%** të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me periudhën janar - qershor 2009, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth 1,218.85 milionë lekë.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë janar - qershor 2009, 2010

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mijë lekë)		Ndryshimi (në %)
	2009	2010	'10/'09-1
Letra me Vlerë të Qeverisë			
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	5,114.25	5,465.55	6.25
Individë	4,241.66	3,892.69	(8.23)
Persona juridike	902.59	1,572.87	74.26
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	661.94	1,559.49	135.59
Individë	409.74	744.44	81.68
Persona juridike	252.19	815.05	223.18

Zhvillimet e tregut të pensioneve vullnetare private për gjashtëmuajorin e parë 2010

Tregu i pensioneve vullnetare zë një peshë të vogël në tregun financiar jo-bankar në Shqipëri. Pavarësisht dinamikës së lartë të rritjes së kontributeve dhe numrit të kontribuesve, përkatësisht në masën 40.86% dhe 8.63% për

gjashtëmuajorin e parë 2010, ky treg është ende larg potencialit të tij real për zhvillim të mëtejshëm.

Më poshtë pasqyrohen disa të dhëna mbi tregun e pensioneve vullnetare private për gjashtëmuajorin e parë 2010:

Tregu i Pensioneve Private Vullnetare (kontribute)

Shoqëria	Kontribute (në lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010		2009	2010
Periudha janar - qershor			`10/`09-1		
Raiffeisen PENSIONS	36,136,250	44,244,405	22.44	58.44	50.80
Capital	13,126,870	28,091,091	114.00	21.23	32.25
Sigma IPP	12,569,362	14,763,362	17.46	20.33	16.95
Total	61,832,482	87,098,858	40.86	100.00	100.00

Tregu i Pensioneve Private (kontribues)

Shoqëria	Numri kontribuesve		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010		2009	2010
Periudha janar - qershor			`10/`09-1		
Raiffeisen PENSIONS	1,661	1,777	6.98	38.74	38.15
Capital	1,705	1,878	10.15	39.76	40.32
Sigma IPP	922	1,003	8.79	21.50	21.53
Total	4,288	4,658	8.63	100.00	100.00

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet seminari mbi mbikëqyrjen me bazë risku

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS¹), në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë zhvilluan në Varshavë, Poloni, gjatë periudhës 26-27 korrik 2010 seminarin me temë: Mbikëqyrja me Bazë Risku.

Seminari i adresohet autoriteteve shtetërore të përfshirë në mbikëqyrjen e pensioneve dhe reformat e pensioneve private në rajonin e Evropës Lindore e Qendrore, si dhe disa vendeve anëtare të IOPS-it. Ai ishte organizuar në kuadër të aktiviteteve globale në terren të IOPS-it dhe në përputhje me objektivin e Organizatës për të promovuar zhvillimin e sistemeve efikase të

¹ The International Organization of Pension Supervisors

pensioneve kombëtare mbikëqyrëse të gjithë botën. Shumë anëtarë të IOPS-it dhe autoriteteve mbikëqyrëse të sistemit të pensioneve të rajonit të Evropës Lindore dhe Qendrore po planifikojnë për të futur një qasje të bazuar në risk në mbikëqyrjen e sistemit të pensioneve. IOPS ka ndërmarrë një projekt të madh për këtë temë, duke përfshirë zhvillimin e një udhëzuesi për të ndihmuar autoritetet mbikëqyrëse të përgatiten për një tranzicion të tillë, si dhe të paraqitjes së disa modeleve të mbikëqyrjes me bazë risku të zhvilluara tashmë nga disa anëtarë të IOPS-it.

Qëllimi i seminarit ishte të paraqiste punën e IOPS-it në këtë fushë dhe të ofronte një mundësi për të mësuar nga këta anëtarë të IOPS-it që e kanë përdorur këtë qasje të bazuar në risk më në detaje.

Seminari u zhvillua sipas disa sesioneve ku u bënë prezantime nga ekspertë të nivelit të lartë.

- o Sesioni i parë i takimit me temë *“Paraqitja e Mbikëqyrjes me Bazë Riskun”*, ju kushtua prezantimit nga sekretariati i IOPS-it të punës të zhvilluar nga IOPS në fushën e mbikëqyrjes bazuar në risk, si edhe një pasqyrë shume efikase të qasjes së zbatuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake.
- o Sesioni i dytë me temë *“Përgatitja për Mbikëqyrjen me Bazë Risku”* kishte synim dhe ju përkushtua organizimit të punës se si autoritetet duhet të përgatiten për futjen e mbikëqyrjes bazuar në risk. Nga sekretariati i IOPS-it u bë një pasqyrë mbi modulën I të Toolkitit, si dhe nga autoritete homologe u dhanë eksperiencat më të mira të fushës si p.sh: nga autoriteti homolog i Australisë, APRA, u bë një pasqyrë e strukturës së mbikëqyrjes dhe mundësitë e zbatimit, si dhe nga autoriteti i Kenias një prezantim mbi përgatitjet e këtij autoriteti për zbatimin e mbikëqyrjes me bazë risku.
- o Sesioni i tretë kishte si temë kryesore

“Mbledhjen e informacionit dhe identifikimin e riskut”, moduli 3 Toolkit. U vlerësuan shumë prezantimi i z. Ross Jones, Presidenti i IOPS, njëherësh nënkryetar i APRA-s, mbi vlerësimin e riskut në autoritetin homolog APRA të Australisë, si dhe prezantimi nga autoriteti homolog i Hungarisë lidhur me mbledhjen e informacionit.

- o Sesioni i katërt trajtoi përlllogaritjen e riskut. I rëndësishëm ishte prezantimi nga sekretariati i IOPS-it mbi një përmbledhje të modulit 4 Toolkit, një prezantim nga APRA dhe autoriteti i Hungarisë.
- o Sesioni final trajtoi dhe dha në mënyrë të përmbledhur udhëzime se si mbikëqyrëse duhet ta vlerësojnë dhe si do t'i përgjigjen kësaj qasje. U prezantua Moduli 5 Toolkit nga sekretariati i IOPS-it u dha një model nga APRA dhe një prezantim nga Kenia.

Ne fund të seminarit u bë një përmbledhje nga Autoriteti i Polonisë dhe Z. Ross Jones, president i IOPS-it.

Aktiviteti u karakterizua nga një interesim i pjesëmarrësve dhe përforcoi domosdoshmërinë e organizimit të takimeve të tilla në drejtim të njohjes dhe shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave me të mira.

Zhvillohet seminari i 6-të i mbikëqyrjes ndërkombëtare të sigurimeve mbi çështjet kryesore të mbikëqyrjes

Gjatë periudhës 18-23 korrik në Beatenberg, Zvicër, FSI zhvilloi seminarin e 6-të të mbikëqyrjes ndërkombëtare të sigurimeve mbi çështjet kryesore të Mbikëqyrjes.

Seminari ishte organizuar në formën e një forumi për shkëmbimin e eksperiencave më të mira lidhur me rolin e rëndësishëm të standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes së sigurimeve, të prezantuara nga IAIS, për një mbikëqyrje efektive

bazuar në metodologjinë me bazë risku.

Këto eksperiencë u prezantuan nga lektorë të fushës shoqëruar me case study, të fokusuar në fushën e licencimit, mbikëqyrjes së grupit, identifikimit dhe mundësive të parandalimit të riskut në shoqëritë e sigurimit që kanë falimentuar (rasti i falimentimit të HIH), etj.

Ekspertët e kësaj fushe ndanë me panelin opinionet e tyre mbi reformat në fushën e mbikëqyrjes dhe masat paraprake që duhet të ndërmerren për një mbikëqyrje efektive të tregut të sigurimeve, duke dhënë observacione krahasuese nga sistemet rregullatore në botë dhe duke vënë theksin në praktikën më të mira ndërkombëtare. Gjithashtu, gjatë seminarit u hodh dritë mbi mësimet që dalin nga kriza financiare e vitit 2008 për:

- o rregullatorët mbarëkombëtarë në drejtim të nevojës së bashkëpunimit (MMoU-ve) dhe përdorimit të standardeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes; dhe
- o industrinë e sigurimeve në drejtim të përmirësimit të qeverisjes së shoqërive të sigurimit dhe menaxhimit të riskut të këtyre shoqërive.

Referuesit e këtyre temave ishin kryesisht përfaqësues të IAIS-it dhe përfaqësues të rregullatorëve të tregut të sigurimeve, të cilët paraqitën shembuj nga jeta reale të abuzimit të tregut, të paaftësisë së rregullatorëve, për të zbuluar dhe parandaluar p.sh. falimentimin e grupit të sigurimeve HIH në vitin 2001 në Australi.

Ndër çështjet që u referuan përmendim:

- o Mbikëqyrja me bazë risku dhe masat për një mbikëqyrje efektive;
- o Matja e risqeve të sigurimit;

o Mbikëqyrja e grupit, bashkëpunimi midis mbikëqyrësve dhe ndarja e informacionit mes tyre;

o Zvogëlimi i riskut dhe risigurimet;

o Qeverisja e shoqërisë së sigurimit, kontrolli i brendshëm;

o Kriza financiare dhe reformat në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregut të sigurimeve.

Seminari u mbyll me prezantimin e planit të veprimit “Për një mbikëqyrje efektive” përgatitur nga grupet e punës pjesëmarrëse në këtë event, të cilët paraqitën opinionet dhe eksperiencat e tyre lidhur me këtë çështje, sipas metodologjisë së mbikëqyrjes që ata përdornin në vendet respektive.

Edukimi i konsumatorit

Përparësitë e një standardi global për aftësinë paguese

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Geneva Papers, Vol. 35, nr. 1, 2010)

Vijon nga numri i kaluar...

Një qasje mbikëqyrjeje globale

Përparësitë e një qasjeje mbikëqyrjeje globale

Pa dyshim, një qasje globale për mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit do të kishte disa përparësi për mbikëqyrësit, për shoqëritë e sigurimit e risigurimit dhe për policmbajtësit e tyre. Shumë vende i kanë ndryshuar ose janë duke i ndryshuar sistemet e tyre rregullatore për të pasur një qasje më të bazuar në risk. Mirëpo, këto përpjekje të izoluara nuk marrin në konsideratë një argument të rëndësishëm: globalizimi në rritje dhe shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit që ushtrojnë aktivitetet në nivel ndërkombëtar me një rrjet të gjerë degësh dhe shoqëri të kontrolluara kanë

nevojë për një standard botëror të mbikëqyrjes.

Harmonizimi i standardeve rregullatore sasiore dhe cilësore përbën avantazh për të gjitha palët e përfshira. Vetë sektori i sigurimeve do të përfitonte nga fakti se duhet të ndjekë një standard të vetëm dhe nuk do të ketë nevojë për shpërndarjen e burimeve në mënyrë që të përmbushë kërkesat e sistemeve rregullatore të shumta. Kjo ka rëndësi të veçantë për shoqëritë që synojnë të zgjerohen në tregje të reja jashtë vendit të tyre. Problemi i kostove dhe burimeve nuk duhet shpërfillur as nga ana rregullatore. Pasja e një standardi mbikëqyrës të njëtrajtshëm do t'u kursente fondet enteve rregullatore, sepse stafi i tyre do të mund të përqendrohej te një paketë rregullash dhe kërkesash ligjore. Përqendrimi në një regjim të vetëm është tërheqës edhe në dritën e standardeve dhe modeleve rregullatore, të cilat po bëhen gjithnjë e më të ndërlikuara dhe më të vështira dhe të cilat kanë nevojë për njerëz me aftësi të veçanta. Lufta për talente, pra kërkimi për persona me njohuri prej eksperti në fushën e aktuaristikës dhe administrimit të riskut, ka filluar tashmë dhe kërkesa për njerëz të tillë është në rritje. Edhe policmbajtësit dhe ndërmjetësit e tjerë do të përfitojnë nga ulja e çmimeve si pasojë e rregullave të barabarta të lojës dhe nga rritja e konkurrencës midis siguruesve dhe risiguruesve dhe nga ulja e shpenzimeve të tyre në lidhje me përmbushjen e kërkesave ligjore të kuadrit rregullator. Po t'i pyesësh policmbajtësit, gati me siguri ata do të mbrojnë idenë e një standardi të njëjtë në të gjithë botën pikërisht për këto arsye. Transparenca është një tjetër kryefjalë në këtë debat. Zbatimi i të njëjtës paketë me standarde nga ana e shoqërive në mbarë botën e minimizon riskun e arbitraritetit rregullator. Një standard i ri i orientuar nga gjetjet më të fundit në sektor do t'i evitojë mangësitë në ecjen përpara.

Shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit që ushtrojnë aktivitet në nivel botëror luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërive vendase përmes marrjes përsipër dhe

shpërhapjes së risqeve dhe përmes marrjes së vendimeve tregtare. Mirëpo, këto aktivitete sjellin me vete edhe riskun e përhapjes së mungesës së stabilitetit ekonomik, i cili do të mund të zbutet përmes pasjes së një regjimi rregullator global. Pasja e një regjimi të tillë do t'u jepte mundësi vendeve të tregonin në mënyrë më të efektshme ekzistencën e tregjeve efçente dhe të qëndrueshme të sigurimit, kundrejt tregjeve financiare të tanishme, të cilat janë të paqëndrueshme dhe të pasigurta dhe kundrejt një skenari të afërm me rënie ekonomike globale. Mbikëqyrësit do të jenë të përgatitur më mirë për ardhjen e krizave të ardhme (për shembull, nga probabiliteti në rritje i epidemive botërore, ashpërsia në rritje e katastrofave natyrore dhe alarmeve terroriste).

Tiparet e një standardi të ardhshëm global për aftësinë pague

Çdo zhvillim drejt një standardi global mbikëqyrës do të kishte gjasa shumë të vogla suksesi nëse nuk do të përfshinte Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, të cilët janë dy tregjet më të mëdha në botë për sigurimin dhe risigurimin. Në këtë pjesë shikohen faktorët e ndryshëm që ka të ngjarë të jenë pozitivë dhe të rëndësishëm për një standard global të aftësisë pague dhe shikohet se si po i trajtojnë këta faktorë tani regjimet mbikëqyrëse në SHBA dhe BE. Ky shikim i përgjithshëm nuk kërkon të jetë shterues, por nënvizon vetëm disa prej faktorëve të rëndësishëm.

Qasja e bazuar në risk

Standardi i ri duhet të nxjerrë një kërkesë për t'u bazuar në risk i cili të marrë në konsideratë të gjitha risqet ndaj të cilave janë të zbuluar shoqëritë. Në llogaritjen e SCR-së, standardi Sovency II merr në konsideratë të gjitha kategoritë kryesore të riskut (për shembull, jo-jetë, jetë dhe përjashtimi shëndetësor, risku i tregut, risku i kreditit dhe risku operativ) të cilët

konsiderohen se kanë një ndikim të mundshëm mbi shoqërinë dhe mund të shprehen në terma sasiore. Përdoret ose një formulë standarde ose një model i brendshëm për të vlerësuar ndikimin e këtyre kategorive të riskut. Procesi i agregimit në formulën standarde merr në konsideratë vartësitë midis nënklasave të secilës kategori risku por merr në konsideratë edhe vartësitë midis kategorive të riskut në nivelin e sipërm të agregimit duke shfrytëzuar një qasje të kovariancës. Modeli i brendshëm mund të përdorte metoda më të ndërlikuara për të parë vartësitë e mundshme siç janë shpërndarjet shumë variante. Modeli amerikan i kapitalit të bazuar në risk konsiston në modele të ndryshme të bazuar në faktorë për siguruesit e jetës, shëndetit dhe jo-jetës. Për shembull, formula e jo-jetës mbulon riskun e aktiveve, riskun e shkrimit (megjithëse modeli nuk merr në konsideratë riskun e katastrofave), riskun e kreditit dhe riskun tregtar, ku përfshihet risku operativ. Vartësitë midis klasave të veçanta të riskut merren në konsideratë vetëm në nivelin e lartë të agregimit, mbështetur në hipotezën se ka vartësi ose pavarësi të plotë. Forma e tanishme e modelit amerikan nuk mund të klasifikohet si një model tërësisht i bazuar në risk, duke qenë se nuk i mbulon të gjitha risqet kryesore ndaj të cilave mund të jetë e zbuluar shoqëria.

Qasja ekonomike

Një qasje ekonomike karakterizohet nga paraqitja e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të vlerësuara sipas vlerës aktuale ose vlerës së drejtë. Kjo i eliminon të gjitha rezervat e fshehura dhe elementet zbutëse dhe paraqet kapitalin ekonomik të shoqërisë si një pasqyrim besnik të gjendjes financiare të saj. Në bazë të Solvency II, u kërkohet shoqërive të përgatisin një bilanc ekonomik. Efektet janë të dukshme sidomos nga ana e pasiveve, aty ku duhet të paraqiten provigjonet teknike mbështetur në një qasje të njëjtë për të gjithë tregun. Kjo do të thotë se në bilancin ekonomik, shoqëritë e sigurimit duhet të paraqesin një marzh risku krahas çmuarjes më të

mirë të skontuar. Marzhi i riskut duhet të garantojë që shoqëria, nëse ndodhet në vështirësi apo në prag falimentimi, të mund të tërheqë një të tretë, i cili të marrë përsipër portofolin. Marzhi i riskut shërben si një normë kthimi të cilën e merr shoqëria e re, mbi kapitalin e riskut, të cilin do të duhej të vinte mënjane. Qasja amerikane përdor informacionin e paraqitur në pasqyrën vjetore të detyrueshme në bazë të normave të kontabilitetit të miratuara nga NAIC. Hë për hë, kjo mund të konsiderohet qasje ekonomike. Mirëpo, një material i NAIC, i vitit 2007, e trajton shprehimisht temën e matjes së vlerës së drejtë, duke përgatitur rrugën për zbatimin e parimeve ekonomike. Për më tepër, edhe puna paralele për standardet e kontabilitetit që ka kryer Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Bordi i Standardeve të Kontabilitetit Financiar synon futjen e parimeve ekonomike dhe të vlerës së drejtë në kontabilitetin ndërkombëtar.

Modelet e brendshme

Pranueshmëria e modeleve të brendshme (të riskut), të cilat konsiderohen se janë më të përshtatshme për të mbuluar situatat e ndërlikuara të riskut, është një tjetër tipar që duhet të ofrojë një standard i ardhshëm global për aftësinë paguese. Në bazë të Solvency II, shoqëritë do të kenë mundësinë e zgjedhjes për të përdorur qasje të modeleve të brendshme për të gjitha risqet ose për një pjesë të risqeve të tyre. Përdorimi i modeleve të brendshme mbrohet nga një proces i plotë miratimi. Qeverisja e modelit do të thotë se duhet të kalohen gjashtë teste, sidomos testi i përdorimit, përpara se të jepet leja për përdorimin e përditshëm. Në dallim nga kjo, NAIC e sheh futjen e modeleve të brendshme si një mjet për modelimin e risqeve në rastet kur qasje standardet japin rezultate më të dobëta. Mirëpo, marrja në konsideratë e modeleve të brendshme për të mbuluar situatat me risk total të siguruesve amerikanë nuk përbën synim dhe as objektiv të rregullatorit. Përkundrazi, NAIC ndjek

një qasje të kujdesshme dhe konservatore kur lejon përdorimin e modeleve të brendshme. Kjo duket qartë edhe nga masat mbrojtëse që janë trupëzuar në futjen e modeleve të brendshme dhe nga fakti se, në përgjithësi, modelet e brendshme e rrisin kërkesën ligjore për kapitalin e detyrueshëm në krahasim me qasjen e bazuar në faktorë.

Standardet e kalibrimit

Modelet mbikëqyrëse arrijnë një shkallë më të lartë transparence dhe ngjallin më shumë interes, nëse kalibrimi i modelit u jep mundësi përdoruesve të vlerësojnë apo krahasojnë nivelin e kujdesit të treguar kundrejt modeleve të tjera (për shembull, qasjet e agjencive vlerësuese). Për formulën standarde dhe modelet e brendshme, Solvency II përdor një tolerancë të përbashkët risku (ngjarje që ndodh 1 herë në 200 vjet) dhe një matje uniforme të riskut (vlera në risk) për të gjitha kategoritë e riskut. Periudha kohore gjatë të cilës vlerësohet risku është një vit, ndërsa kjo qasje merr si të qenë se ka një situatë vijuese. Formula amerikane e llogaritjes së kapitalit nuk është e kalibruar kundrejt një niveli specifik besimi, ndërsa elementet përbërëse të modelit të brendshëm në përgjithësi kalibrohen duke përdorur vlerën e shpërndarjes statistikore të riskut si matje të riskut.

Qasja e bazuar në parime

Kriza e tregut financiar ka nxjerrë në pah përparësitë e kuadrit rregullator të bazuar në parime, ekonomike dhe të bazuar në risk për qëndrueshmërinë e sektorit financiar. Rregullimi i bazuar në parime do të ngrejë një sërë sfidash për shoqëritë e sigurimit dhe mbikëqyrësit. Siguruesit do të përballen me më shumë pasiguri, duke qenë se qasja e bazuar në parime do të lërë më shumë fushë për interpretim lidhur me atë se cilat kërkesa ligjore duhet të përmbushë shoqëria. Drejtuesit e lartë do të kenë përgjegjësinë e fundme për të siguruar se shoqëria është duke punuar sipas objektivave

rregullatore. Në dallim nga situata me qasje rregullatore të bazuar në norma, nuk do të mjaftojë më thjesht përmbushja e kërkesave ligjore specifike të paracaktuara. Funksione të tilla si administrimi i riskut, auditimi i brendshëm dhe zbatimi i kërkesave ligjore do fitojnë më shumë rëndësi. Sipas qasjes të bazuar në parime, mbikëqyrësit do të kenë më shumë të drejta, por do të kenë edhe më shumë detyrime. Për shkak të shkallës së lirisë në rregullim, ata do të duhet të kenë një njohuri shumë të mirë të qasjeve të shoqërive dhe do t'u duhet të merren me çështje komplekse (për shembull, procesi i miratimit për modelet e kapitalit të brendshëm). Për më tepër, do të kenë elasticitetin, por edhe barrën, për të vendosur për shkallën e rëndësisë materiale dhe proporcionalitetit që duhet të mbajnë në konsideratë shoqëritë në lidhje me kërkesat rregullatore për zbatimin e akteve normative. Nuk do ekzistojë më metoda “një mjet vlen për të gjithë”. Standardi i ardhshëm Solvency II, i cili pritet të zbatohet në vitin 2012, do të jetë i bazuar në parime. Mirëpo, procesi i tanishëm i Nivelit 2 dhe specifikimi i masave zbatuese të lënë të kuptosh se autoritetet rregullatore janë më shumë të prirë nga njëfarë shkalle mbikëqyrjeje të bazuar në norma, gjë që duhet evituar dhe kundërshtuar nga sektori dhe palët e tjera të interesuara. Qasja amerikane mund të karakterizohet si e bazuar në norma, por janë të dukshme që tani disa prirje në drejtim të një trajtimi më shumë të bazuar në parime.

Drejtim i riskut

Qasja e Solvency II në lidhje me drejtimin e riskut e vë theksin te përgjegjësia e fundme e drejtuesve të lartë për të gjitha aktivitetet e administrimit të riskut. Shoqëritë nxiten të krijojnë funksione për administrimin e riskut, zbatimin e kërkesave ligjore, auditin e brendshëm dhe operacionet e aktuaristikës për të mundësuar proceset e duhura të drejtimin të riskut. Krahas masave mbrojtëse sasiore, futja e këtyre masave shihet si një mjet i mëtejshëm për zbutjen dhe mbajtjen në kontroll të pozitave të

brishta të shoqërive, në raport me ngjarjet e padëshirueshme në tregjet e sigurimeve dhe të kapitalit. Në këtë proces, vlerësimi vetjak i riskut dhe aftësisë paguese është konceptuar si një instrument i cili u kërkon ndërmarrjeve të sigurimit dhe risigurimit të vlerësojnë si duhet risqet e tyre afatshkurtra dhe afatgjata dhe sasinë e fondeve të veta të nevojshme për t'i mbuluar këto risqe. Qasja e tanishme në SHBA nuk ka një diçka të ngjashme apo të njëjtë me vlerësimin vetjak të riskut dhe aftësisë paguese. Nuk ka kërkesa të vendosura shprehimisht për të publikuar një dokument me një vlerësim të brendshëm të risqeve, me hollësi për sistemin e administrimit të riskut apo për profilin e riskut të shoqërisë, i cili t'i dorëzohet autoritetit rregullator.

Mbikëqyrja e grupeve

Një tipar i nevojshëm i një standardi global të aftësisë paguese do të ishte mbikëqyrja e grupit, ku mbikëqyrësi i grupit do të ishte nga ai vend ku ka selinë shoqëria. Solvency II e ka përqafuar këtë ide dhe ideja është të zgjidhet kryembikëqyrësi nga ai vend ku është e regjistruar shoqëria mëmë. Mbikëqyrësit nga shtetet ku grupi ka shoqëri të kontrolluara dhe degë do të marrin pjesë në një “kolegj mbikëqyrësish”. Ky grup do të marrë vendime miqësore në lidhje me çështjet e aftësisë paguese të grupit të shoqërive. Një zhgënjim për grupet është hedhja poshtë e regjimit mbështetës të grupit, i cili do t'u kishte dhënë mundësi grupeve të nxirrnin më shumë përfitim nga diversifikimi që do të rridhte nga struktura e përzgjedhur e degëve dhe shoqërive të kontrolluara që ushtrojnë aktivitet në juridiksione të ndryshme. Por, ky koncept do të rivlerësohet tre vjet pas futjes në zbatim të Solvency II. NAIC ka zhvilluar konceptin e kryembikëqyrësit shtetëror për grupet, sipas të cilit mund të zgjidhet një shtet ose disa shtete për të vepruar si kryembikëqyrës për detyra të

ndryshme të mbikëqyrjes së aftësisë paguese të grupeve. Mirëpo, nuk ka një vlerësim të aftësisë paguese të grupeve, nuk ka as një koncept për të njohur përfitimet që rrjedhin nga diversifikimi i risqeve apo nga lëvizshmëria e kapitalit brendapërbrenda grupit.

Kërkesat kolaterale

Një qasje e vërtetë mbikëqyrëse globale nuk duhet të ketë asnjë kërkesë kolaterale, duke qenë se kërkesa të tilla e pengojnë seriozisht fluksin eficient dhe shpërndarjen e kapitalit. Megjithatë, ende vazhdojnë të ekzistojnë forma të ndryshme të kërkesave të tilla, të cilat janë një burim i përhershëm acarimi. Autoritetet rregullatore pranojnë edhe nevojën për ta ndryshuar praktikën e tanishme dhe projekt-propozimet e kohëve të fundit të NAIC përbëjnë një lëvizje nxitëse në këtë drejtim. Risiguruesit jo amerikanë, tani për tani, duhet të vërtetojnë se kanë krijuar 100% kolateral për risqet në SHBA pranë një banke në SHBA. Kuadri i ndryshuar nga NAIC propozon lehtësimin e kësaj praktike. Në bazë të kësaj, NAIC do të caktojë një nga pesë vlerësime për risiguruesit jo amerikanë. Në vlerësimin më të mirë, shkalla e vlerësimit 1 do të thotë se nuk do të kërkohej asnjë kolateral; në pjesën e poshtme të shkallës së vlerësimit (shkalla e vlerësimit 5) do të kërkohej 100% kolateral, si edhe tani. Ky duket një hap drejt një qasjeje më të bazuar në risk dhe më ekonomike. Solvency II parashikohet të miratojë zbutjen e riskut të risigurimit nga shoqëritë që i përmbushin kërkesat ligjore dhe që nuk i shkelin kërkesat për kapital dhe aftësi paguese pa asnjë kërkesë kolaterale.

Vijon në numrin tjetër..

Për këtë numër punuan:

**E. Shehi, R. Guri, A. Dervishi,
L. Rama, R. Eltari, E. Kokona**

